Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1001

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Quantix" Sh.P.K. të datës 11.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit të datës 21.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM" me numër të prokurimit UA/2016-23-9009-2-1-1,në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 27.02.2024 merr këtë:

Vendim

I. Aprovohet si e pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Quantix" Sh.P.K. me nr. 2023/1001 e datës 11.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit të datës 21.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM" me numër të prokurimit UA/2016-23-9009-2-1-1.**Kurse** Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit i datës 21.11.2023.

II. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së asnkesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 04.09.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM" me numër të prokurimit UA/2016-23-9009-2-1-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 250,000.00€.

Me datë 21.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Data Prognet" Sh.P.K.

Me datë 27.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 30.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 11.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1001.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I) -** "*OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim dispozitat e LPP duke mos lejuar qasje të plotë në dokumentet e tenderit të OE të rekomanduar*".

- **Pretendimi i dytë (II) -** "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat 2 dhe 3 të kapacitetit teknik dhe profesional. Pretendimi është bërë mbi bazën e supozimit pa kontestuar një kërkesë apo dëshmi specifike*".
- **Pretendimi i tretë (III) -** *"OE ankues pretendon se ne mungesë të qasjen në të dhëna të aktivitetit financiar përkatësisht".*
- **Pretendimi i katërt (IV) -** "*OE ankues pretendon se OE i rekomanduar ka dorëzuar tender me çmim jonormalisht të ulët, rrjedhimisht AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke e cilësuar si tender të përgjegjshëm dhe rekomanduar për kontratë*".
- **Pretendimi i pestë (V) -** "*Ankuesi pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP duke kërkuar sqarime në lidhje me deklaratën për mirëmbajtje, për shkak të mospërputhjes*".
- **Pretendimi i gjashtë (VI) -** *"OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke kërkuar sqarime në lidhje me aspekte teknike të propozimit teknik të dorëzuar nga OE i rekomanduar".*
- **Pretendimi i shtatë (VII) -** *"OE ankues pretendon se tenderët e dorëzuar nga OE-të Tech Vision Sh.p.k; Protecht Sh.p.k; Komtel Project Enginiering Sh.p.k kanë dorëzuar tender të cilët janë të papërgjegjshëm për mosplotësimin e kritereve/kërkesave të dosjes së tenderit".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 10, 11, 59, 60 dhe 69 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues **në** vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të datës 30.11.2023 AK refuzuar si të Pa bazuar pretendimet ankimore me asnjë provë dhe argument bindës sepse nga cilësia jonë si AK kemi vepruar komform nenit 1 te LPP-së OE i rekomanduar për kontratë është OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e DT-së gjithashtu ka ofruar çmimin më të lirë. AK në asnjë rrethanë nuk ka vepruar në kundershtim me nenin 10 dhe 11 sepse OE ankues i është dhënë çasja menjëherë pas parashtrimit të kërkesës. Lidhur me pretendimet për nenet 6 dhe 7 që OE i rekomanduar ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e caktuara në DT dhe njoftimin për kontratë, gjithashtu lidhur me propozimin teknik për projektin kjo nuk ka qenë kërkesë e DT dhe si e tillë nuk ka qenë pjesë e vlerësimit nga ana e komisionit të vletresimit të ofertave, duke vepruar kështu në harmoni me nenin 56.3 lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta. Poashtu Operatorit ekonomik ka kthyer përgjigje dhe ka sqaruar në detaje se çfarë programi posedon dhe si do të punojnë të përmirësojnë këtë program më tutje ashtu siç është kërkuar në specifika dhe komisoni i vlerësimit përgjigjen e cituar e ka konsideruar si të pranueshme dhe në harmoni me kërkesat e DT. Ju rikujtojmë edhe një herë se kjo pjesë specifika teknike dhe koha e zbatimit të projektit që ju ju keni refereuar(si plani dinamik) është kërkuar që të përmbushet në një deklaratë me shkrim të cilat OE në fjale i ka bashkangjitur dhe ju keni pas çasje. Lidhur me pretendimin tjetër për çmime abnormalisht të uleta AK ka ndejkur procedura sipas nenit 61 te LPP-së dhe është bindur me sçarimet e ofruara. Andaj në bazë të kësaj që u tha me lartë AQP si AK në emër tëe agjensisë së pavarur për media kërkon nga OSHP që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi AK-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues ndërsa me datë 19.12.2023 ka angazhuar ekspertin teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore. Me datë 28.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së*".

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Ankuesi me datë 23.11.2023 përmes emailit ka kërkuar qasje ne dokumentet tenderuese te gjithë OE-ve qe kane marre pjesë në këtë aktivitet dhe në raportin e vlerësimit përfshirë të gjithë dokumentet që ndërlidhen me vlerësimin. Në të njëjtën ditë, AK përmes emailit ka informuar OE ankues që mund të kenë qasje nga ora 14:30 në AK. OE ankues përsëri me datë 24.11.2023 ka dërguar email në lidhje me qasjen. Eksperti shqyrtues dhe teknik kanë verifikuar se OE ankues në tenderin e tij ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist të nënshkruar dhe vulosur. Eksperti Shqyrtues dhe teknik sqarojnë se AK ka vepruar në pajtim me parimet dhe dispozitat e LPP duke siguruar qasje të arsyeshme OE ankues dhe në të njëjtën kohë ka zbatuar kërkesat e nenit 11duke mbajte si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste nga OE i rekomanduar. Megjithatë, AK gjatë klasifikimit të informatave sipas kërkesës së OE të rekomanduar është dashur që të bëj analizimin në kuptimin që kontratat dhe referencat e lëshuara nga një autoritet publik të mos i klasifikojë si informatat sekrete afariste. Kjo sepse nga 12 kontratat në listën e kontratave, 10 prej tyre janë të lidhura ndërmjet OE të rekomanduar për kontratë me institucione publike. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar". **Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me pretendimin ankimor për mosplotësimin e kërkesave që lidhet me stafit, konform kërkesave numër 2 dhe 3 të dosjes së tenderit, përkatësisht dëshmive të kërkuara, OE i rekomanduar ashtu sikurse është sqaruar në mënyrë të detajuar mësipër ka dorëzuar listën e stafit dhe dëshmitë përkatëse për plotësimin e kërkesave. Rrjedhimisht, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar".**Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, përkatësisht kapacitetin ekonomik dhe financiar, AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk ka përcaktuar ndonjë kërkesë. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar". **Lidhur me pretendimin e katërt (IV) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta të konstatuara sipas kritereve të nenit 41.3 të RrPP, AK ka zbatuar procedurën inter partes konform nenit 41.2 RrPP. Më tej, OE ankues i rekomanduar ka dorëzuar sqarime ku ka bërë zbërthimin e kostove të parallogaritura për të gjitha elementet e ofertës. Konform nenit 41.10, AK pas pranimit të sqarimeve nga OE i rekomanduar është bindur që oferta duhet të trajtohet njëjtë me tenderët tjerë. Prandaj, AK ka vepruar në përputhje me nenin 1 dhe 6 të LPP dhe nenin 41.10 të RrPP, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar". **Lidhur me pretendimin e pestë (V) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues dhe teknik fillimisht sqarojnë se është evidente se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë dy afate të ndryshme në dy dokumente në lidhje me periudhën mirëmbajtjes. Afatin prej 24 muaj në deklaratën për mirëmbajtje dhe afatin 12 muaj në planin dinamik. Duke qenë që dy afatet e deklaruara të mirëmbajtjes përmbushin afatin minimal prej 12 muaj të specifikuar në dosjen e tenderit, atëherë sqarimi i AK është në funksion të qartësimit të informatave të dhëna në tenderin e OE të rekomanduar. Andaj eksperti shqyrtues". **Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se nisur nga fakti që AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nuk ka përcaktuar kërkesë për dorëzimin e propozimeve teknike, sqarimet e AK-së janë në funksion të shtjellimit të zgjidhjeve që duhet të implementohen dhe është e qartë që OE-të duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të paraqitura në dosjen e tenderit gjatë fazës së

implementimit. Megjithatë, konform nenit 56, paragrafi 3 i LPP-së, tenderuesi nuk mund të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë”.**Lidhur me pretendimin e shtatë (VII) ankimor,** eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: “Në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues për tenderët e OE-ve Tech Vision Sh.p.k; Protecht Sh.p.k; Komtel Project Enginiering Sh.p.k, eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 21.11.2023, OE e sipër përmendur janë eliminuar dhe të njëjtit nuk kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, rrjedhimisht nuk janë palë me interes material në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj pretendimet ankimore në lidhje me tenderët e këtyre OE-ve janë të palejuara”.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues dhe teknik kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. dhe teknik Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimi i parë ankimor është pjesërisht i bazuar ndërsa pretendimet ankimore të tjera janë të pabazuara në fakte dhe argumente bindëse. Lidhur me pretendimin e pare ekspertët e shqyrtues dhe teknikë kanë verifikuar se OE i rekomanduar, ka dorëzuar kërkesën për të mbajtur informacionet e klasifikuara si sekrete afariste, duke e nënshkruar dhe vulosur atë. Ata kanë sqaruar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me ligjin duke siguruar qasje të arsyeshme për ankuesin dhe po ashtu kanë respektuar kërkesat për mbrojtjen e informacioneve si sekrete afariste. Megjithatë, gjatë klasifikimit të informatave sipas kërkesës së ankuesit, Ekspertet sqarojnë se AK do duhej të kishte analizuar në mënyrë të veçantë kontratat dhe referencat e lëshuara për OE e rekomanduar nga autoriteti publik, duke mos i klasifikuar ato si informacione sekrete afariste. Kjo për shkak se nga 12 kontratat në listën e kontratave, 10 prej tyre janë të lidhura me operatorë ekonomikë të rekomanduar për kontrata me institucione publike. Prandaj, pretendimi ankimor është gjetur pjesërisht i bazuar. Lidhur me këtë Paneli sqaron se AK është e detyruar të veproj në përputhje me kërkesat e Nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht paragrafi 4 i cituar 4. Autoriteti Kontraktues, nëse ka klasifikuar një element të informatës si informacion sekret afarist sipas paragrafit 3 të këtij nenit, duhet të përgatisë një version të "pastruar" të dokumentit për tu përfshirë në materialin e publikuar për palët e interesuara, duke siguruar që elementet e tilla sekrete afariste të hiqen ose fshihen. për shkak të një kërkese të operatorit ekonomik përkatës. Ai duhet gjithashtu të bashkëngjisë një njoftim që shpjegon se dokumenti i pastruar është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes së informacioneve sekrete afariste. Lidhur me pretendimin e dytë,

ekspertët shqyrtues konstatuan se Operatori Ekonomik (OE) i rekomanduar ka plotësuar kërkesat për staf, duke dorëzuar listën e stafit dhe dëshmitë përkatëse. Prandaj, pretendimi në këtë pikë është gjykuar i pabazuar. Lidhur me pretendimin e tretë, paneli shqyrtues zbuloi se Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar kërkesa për gjendjen ekonomike dhe financiare në dosjen e tenderit. Prandaj, pretendimi në këtë çështje është vlerësuar si i pabazuar po ashtu. Lidhur me pretendimin e katërt, ekspertët konkluduan se AK ka zbatuar procedurën e duhur për çmimet e ulëta sipas kritereve të Rregullores së Prokurimit Publik (RrPP). Sipas tyre, veprimi i AK-së është në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme, duke e bërë pretendimin e operatorit ekonomik të pabazuar. Lidhur me pretendimin e pestë, paneli shqyrtues vlerësoi se sqarimi i dhënë nga AK për afatet e ndryshme të mirëmbajtjes është në përputhje me informacionet e prezantuara në dosjen e tenderit. Prandaj, pretendimi edhe në këtë pikë është gjetur i pabazuar. Lidhur me pretendimin e gjashtë, ekspertët sqarojnë se AK nuk ka përcaktuar kërkesë për dorëzimin e propozimeve teknike në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit kurse sipas ligjit, tenderuesit në asnjë nuk mund të diskualifikohet për shkak të një kërkese që nuk është e përcaktuar në njoftim. Prandaj, pretendimi në këtë pikë është gjykuar si i pabazuar. Lidhur me pretendimin e shtatë, paneli shqyrtues ka konstatuar se OE-ve Tech Vision SHPK, Protecht Sh.p.k; Komtel Project Enginiering Sh.p.k janë eliminuar nga procesi i prokurimit dhe nuk kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Prandaj, pretendimet e këtyre OE-ve janë të palejuara, pasi ata nuk kanë të drejtë ligjore për të kundërshtuar vendimin e AK-së në këtë çështje.

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"* kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të pabazuar. Paneli ne zabtim te nenit 1, dhe 6 të LPP-së pati parasysh po ashtu faktin se oferta e OE të rekomanduar përmban çmim dukshëm më të ulët apo mbi 100% se oferta e ankuesit. Andaj pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues dhe teknik, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar kurse duhet vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit të datës 21.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM" me numër të prokurimit UA/2016-23-9009-2-1-1. Megjiathë duhet theksuar po ashtu se AK mbanë përgjegjegjësinë sipas nenit 24.2 cituar "*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"*.

Vendimi sikurse në pikën II të dispozitivit për të kthyer mjetet për operatorin ankues është marrë me bazë në nenin 31, paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, në kontekst të nenit 118 të Ligjit të Prokurimit Publik. Ky vendim është argumentuar në mënyrë bindëse, duke u mbështetur në faktet dhe dispozitat ligjore relevante. Bazuar në argumentimin e përshkruar më sipër, është vërtetuar se Autoriteti Kontraktues ka mohuar pjesërisht të drejtën e operatorit ankues për të pasur qasje të papenguar dhe të plotë në dokumente publike, në përputhje me nenin 10 dhe 11 të LPP-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga ekspertët shqyrtues.

Për shkak të mungesës së arsyeve të mjaftueshme për të mbrojtur këtë kufizim, operatori ankues ka zgjedhur të drejtohet tek OSHP për të paraqitur ankesën e tij/saj dhe për të mbrojtur interesat e tij/saj në këtë aktivitet të prokurimit, meqenëse i njëjti sipas vendimit të AK kishte rezultuar si i sukseshëm por me çmim më të lartë.Paneli shqyrtues, në lidhje me këtë, ka shpreh shqetësimin e tij/saj për lëshimet e tilla. Ky argument, i bazuar në bazat ligjore dhe faktet e rastit, thekson rëndësinë e respektimit të të drejtave të operatorëve ekonomikë dhe parandalimin e veprimeve të ngjashme të Autoritetit Kontraktues në të ardhmen. Nëse këto lëshime përsëriten, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e ligjit dhe për të mbrojtur të drejtat e të gjithë palëve të interesuara në procedurat e prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 1,6 dhe 117 të LPP është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Agjencia Qendrore e Prokuimit**
- OE - **Quantix L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: